

ABSTRAKTI

Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare janë veprime të kundërligjshme, pasojat e të cilave dëmtojnë dhe rrezikojnë funksionimin e rregullt të organeve shtetërore. Këto vepra penale kryhen nga persona të cilët ushtrojnë veprimtari në institucione publike. Këta persona keqpërdorin besimin e dhënë për të ushtruar detyrën e tyre me nder, ndërgjegje dhe profesionalizëm, duke abuzuar dhe duke shkelur normat juridike dhe etike. Legjislacionet penale moderne të shteteve demokratike sanksionojnë veprimet e tilla e në raste të caktuara parashihen edhe dënime të rënda për kryerësit e këtyre veprave penale. Pasojat e korrupsionit dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare i bartin qytetarët në pothuajse çdo sferë të jetës shoqërore. Në shtetet ku janë të pranishme në shkallë të lartë këto dukuri shfaqen edhe probleme tjera shoqërore, si: cenimi i të drejtave dhe lirive të njeriut; mungesa e besimit në institucionet publike; pamundësia e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje; mungesa e mjedisit të përshtatshëm për të jetuar; pamundësia për të krijuar pasuri etj.

Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare përfshijnë veprimtari të ndryshme kriminale që kryhen nga persona zyrtarë, por edhe nga persona tjerë dhe shfaqet në forma të ndryshme, si: keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar; përvetësimi në detyrë; marrja e ryshfetit (korrupsioni pasiv); dhënia e ryshfetit (korrupsioni aktiv); konflikti i interesit; falsifikimi i dokumenteve zyrtare etj.

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës janë paraparë disa norma juridike të natyrës penale-materiale të cilat sanksionojnë çfarëdo veprimi apo mosveprimi me anën e të cilit keqpërdoret apo abuzohet detyra zyrtare. Përveç këtij ligji, në Republikën e Kosovës ekzistojnë edhe ligje tjera të cilat si objekt rregullimi kanë këtë fushë. Disa nga këto ligje janë: Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik; Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, i bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit; Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Fjalët kyçe: Korrupsion; Konflikt interesi; Detyrë zyrtare; Përvetësim në detyrë; Person zyrtar.